



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I MINISTRAVE

MINISTËR SHTETI PËR MBROJTJEN E SIPËRMARRJES



Raporti  
mbi trajtimin e ankesave dhe  
sugjerimeve të sipërmarrjes  
për muajin prill 2019



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KRYEMINISTRIA

### MINISTËR SHTETI PËR MBROJTJEN E SIPËRMARRJES

Të nderuar miq sipërmarrës,

Në vijim të komunikimit me ju, në rolin e Ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, me qëllim përditësimin tuaj mbi punën e bërë gjatë këtij muaji, lejomëni të ndaj me ju raportin e muajit prill 2019 si dhe trajtimin e ankesave në kuadër të njoftimeve periodike.

Gjatë pjesëmarrjes në takimin e organizuar nga Ambasada Italiane në lidhje me riaktivizimin e tavolinës së energjisë u theksua rëndësia e bashkëpunimit rajonal për të krijuar ura ndërlidhëse energjitike ndërmjet vendeve të rajonit.

Për t'u njohur në mënyrë më të detajuar me problematikat e prodhuesve shqiptarë, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë u zhvillua interpelanca (live) me përfaqësues të Shoqatës së Prodhuesve Shqiptarë. Fokusi i kësaj interpelance ishte taksa e plastikës përsa i përket lëndëve të para për prodhimin e produkteve të plastikës si dhe disa produkteve të tjera të cilat përdoren në sektorin e ndërtimit për rritjen e efikasitetit të energjisë. Në lidhje me këto çështje u dakordësua adresimi i tyre në aspektin legjislativ dhe administrativ.

Në takimet e organizuara me Dhomën Gjermane të Tregtisë dhe Industrisë Shqipëri si dhe Dhomën e Tregtisë dhe Industrisë Shqipëri-Turqi jemi vënë në dijeni për çështje të ndryshme të cilat janë shqetësuese për zhvillimin e biznesit në vendin tonë dhe në vijim kemi kërkuar nga institucionet përkatëse gjetjen e zgjidhjeve dhe komunikimin me sipërmarrjen në lidhje me procedurat që këto institucione ndjekin.

Zhvillime të rëndësishme ka patur gjatë këtij muaji përsa i përket ndryshimeve ligjore në lidhje me mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit në vendin tonë. Në sajë të një bashkërendimi intensiv të takimeve ndërmjet përfaqësuesve të shoqatës së Bashkimit të Tregtarëve të Shqipërisë dhe përfaqësuesve të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes

Sociale janë diskutuar të gjitha risitë që sjell ky projektligj dhe janë drejt finalizimit çështjet më thelbësore të tij.

Duke shpresuar në vijimin e komunikimit me ju, shpreh bindjen time të thellë se nëpërmjet bashkëpunimit ne mund të përmirësojmë klimën e të bërit biznes në vendin tonë.

Me konsideratën më të lartë,  
Eduard Shalsi



## Regjistri i ankesave të trajtuara

Nr.	Instucioni përgjegjës	Data	Tematika	Rezultati
Nr.1	MFE	11.07.2018	Subjekti kërkon kryerjen e pagesës për shërbimet e kryera në fushën e Emergjencave Civile.	Në proces
Nr. 2	MSHMS	17.11.2018	Subjekti ankohet në lidhje me rekomandimet e vendosura nga KLSH.	Trajtuar me zgjidhje
Nr. 3	MB	06.12.2018	Subjekti ankohet në lidhje me Urdhrin e përbashket "Përndalimin e hedhjes në treg të lendeve piroteknike dhe fishekzjarrve për përdorim civil, që rrezikojnë sigurinë publike, jetën dhe shëndetin e njerëzve".	Në proces
Nr. 4	DPT	09.01.2019	Subjekti ankohet mbi sjelljen e nënpunësve tatimorë.	Në proces
Nr. 5	Bashkia - Qarku Shkoder	12.01.2019	Subjekti kërkon adresim ose sugjerim të procedurave që duhet të ndiqen përsa i përket transportit urban dhe marrdhënieve me Bashkinë.	Në proces
Nr. 6	MFE dhe MZHBR	24.01.2019	Subjekti ankohet në lidhje me ndryshimet ligjore të paketës fiskale mbi Ligjin për Taksat Kombëtare.	Trajtuar me zgjidhje
Nr. 7	Inspektoriati i Mjedisit	01.02.2019	Subjekti kërkon asistencë për pajisjen me lejen mjedisore dhe përgjigje ndaj kërkesës online.	Në proces
Nr. 8	MFE	10.02.2019	Subjekti pretendon se automjete të pa licencuara për transport udhëtarësh i bëjnë konkurrencë të pandershme.	Trajtuar me përgjigje
Nr. 9	MFE	12.02.2019	Subjekti kërkon ndryshim ligjor në lidhje me taksën e ambalazhit për produktet e polisterolit.	Trajtuar me zgjidhje
Nr. 10	AKT	13.02.2019	Subjekti kërkon likuidim të detyrimeve kontraktuale nga AKT.	Në proces
Nr. 11	Bashkia - Qarku Korce	15.02.2019	Subjekti kërkon asistencë financiare për fonde nga ana e institucioneve publike për të hapur një veprimtari biznesi	Trajtuar me përgjigje
Nr. 12	MBZHR	17.02.2019	Kërkesë për interpelancë	Në proces
Nr. 13	AKU	19.02.2019	Subjekti kërkon mbrojtjen e të drejtës së ekskluzivitetit si dhe moscënimin e sigurisë ushqimore.	Në proces
Nr. 14	MFE/DPD	19.02.2019	Subjekti ankohet për trajtim abuziv nga ana e institucioneve tatimore dhe doganore.	Trajtuar me përgjigje
Nr. 15	KPP	22.02.2019	Subjekti ankohet se KPP nuk pranon ankesën e tyre mbi procedurën e prokurimit me objekt "Prishje i ish Frigoriferit në Vlore".	Në proces
Nr. 16	MIE	22.02.2019	Subjekti ankohet për pjesmarrje në procedurën konkurruese leje kërkim-zbulimi.	Në proces

Nr.	Instucioni përgjegjës	Data	Tematika	Rezultati
Nr. 17	Bashkia - Qarku Kurbin	24.02.2019	Subjekti kërkon leje për fillimin e punës së HEC-it.	Në proces
Nr. 18	Bashkia - Qarku Korçe	25.02.2019	Subjekti ankohet në lidhje me mosshlyerjen e detyrimeve për projektet e financuara nga Fondi i Zhvillimit të Rajoneve për Infrastrukturën Vendore dhe Rajonale.	Në proces
Nr. 19	AKU	26.02.2019	Subjekti ankohet për kontrolle të shumta dhe të pajustificuara nga AKU	Trajtuar me përgjigje
Nr. 20	MSHMS	26.02.2019	Subjekti kërkon permbytjen e urdherit të ekzekutimit.	Në proces
Nr. 21	MFE/DPD	01.03.2019	Subjekti pretendon se ka pasur veprime arbitrare nga dogana në lidhje me rivlerësimin e deklarave doganore.	Trajtuar me zgjidhje
Nr. 22	DPT	06.03.2019	Subjekti ankohet për penalitete të larta nga administrata tatimore.	Në proces
Nr. 23	MFE	10.03.2019	Subjekti pretendon se automjete të pa licencuara për transport udhëtarësh i bëjnë konkurrence të pandershme.	Trajtuar me përgjigje
Nr. 24	MD	10.03.2019	Subjekti kërkon legalizimin e objektit ku ushtron aktivitetin bar-kafe.	Në proces
Nr. 25	MSHMS	12.03.2019	Subjekti kërkon informacion të mëtejshëm në lidhje me formatin e flete analizave për eksport.	Në proces
Nr. 26	DPD	13.03.2019	Subjekti kërkon hapjen e një nipti sekondar nga Drejtoria Doganore.	Në proces
Nr. 27	MIE	14.03.2019	Subjekti kërkon përmirësimin e infrastruktures rrugore për të biznesi i tij.	Në proces
Nr. 28	MFE	15.03.2019	Subjekti ankohet për kushte diskriminuese për lejimin e ushtrimit të profesionit arkitekt dhe inxhinier.	Në proces
Nr. 29	MFE	15.03.2019	Subjekti kërkon rishikimin e kërkesës për punësimin e një inxhinieri mekanik pranë servisit të tij duke qënë se nuk ofron shërbime të tilla.	Trajtuar me përgjigje
Nr. 30	DPT	16.03.2019	Subjekti ankohet për vendosjen e një gjobe.	Në proces
Nr. 31	DPT	16.03.2019	Subjekti ankohet për gjobitje të padrejtë nga ana e DPT.	Trajtuar me përgjigje
Nr. 32	DPD	18.03.2019	Subjekti ankohet për hyrjen e naftës në mënyrë jo ligjore	Trajtuar me zgjidhje
Nr. 33	Bashkia - Qarku Durrës	18.03.2019	Subjekti kërkon pagesën e detyrimeve të prapambetura nga ana e Bashkisë Durrës për punimet e kryera nga subjekti në vitin 2014.	Në proces

Nr.	Instucioni përgjegjës	Data	Tematika	Rezultati
Nr. 34	MEPJ	18.03.2019	Subjekti ankohet në lidhje me kriteret e perzgjedhjes për një procedurë tenderi.	Në proces
Nr. 35	DPT	20.03.2019	Ankesë për vonesë në rimbursimin e TVSH-së	Trajtuar me zgjidhje
Nr. 36	MFE	21.03.2019	Subjekti kërkon përfshirjen e fidanëve të shafranit në listën e inputeve bujqësore të përjashtuara nga TVSH-ja.	Në proces
Nr. 37	DPT	21.03.2019	Kërkesë për rimbursimin e TVSH-së brenda afateve të caktuara ligjore.	Trajtuar me zgjidhje
Nr. 38	MFE/DPT	23.03.2019	Subjekti denoncon shitjen e biletave në portin e Durrësit.	Trajtuar me përgjigje
Nr. 39	QKB	24.03.2019	Subjekti kërkon asistencë për marrjen e licenses së biznesit	Trajtuar me përgjigje
Nr. 40	MD	26.03.2019	Subjekti kërkon regjistrimin pranë ZVRPP	Trajtuar me përgjigje
Nr. 41	DPT	27.03.2019	Subjekti ankohet për vonesë prej tre muajsh për rimbursimin e TVSH-së.	Trajtuar me përgjigje
Nr. 42	DRT- Berat	28.03.2019	Subjekti kërkon rimbursimin e TVSH-së kreditore.	Trajtuar me zgjidhje
Nr. 43	MFE/DPT	28.03.2019	Subjekti denoncon konkurrencën e pandershme që zhvillohet nga bizneset online të përgjithshme në QKB që operojnë përmes Instagram & Facebook.	Në proces
Nr. 44	Bashkia – Qarku Elbasan	29.03.2019	Subjekti kërkon asistencë për zbardhjen e Lejes së Ndërtimit të aprovuar në 2007 nga Bashkia e rrethit Elbasan.	Në proces
Nr. 45	MIE	29.03.2019	Subjekti ankohet në lidhje me faturim të pasaktë të energjisë elektrike.	Në proces
Nr. 46	MD /Aluizni	01.04.2019	Subjekti kërkon informacion në lidhje me statusin e dosjes së tij nga zyra e Aluiznit.	Në proces
Nr. 47	MTM	01.04.2019	Subjekti kërkon informacion në lidhje me Ligjin për Gjuetinë.	Në proces
Nr. 48	Bashkia- Qarku Vlorë	01.04.2019	Ankesë për "Moszbatim Vendimi të Gjykatës së formës së prerë nga Bashkia Vlorë".	Trajtuar me përgjigje
Nr. 49	DPTTV	02.04.2019	Subjekti ankohet për taksë të larta nga Bashkia e Tiranës.	Trajtuar me përgjigje
Nr. 50	MTM	02.04.2019	Subjekti ankohet për masë administrative gjore të vendosur nga Inspektoriati Shtetëror i Mjedisit e Pyjeve.	Trajtuar me zgjidhje
Nr. 51	MTM	02.04.2019	Ankesë për moszbatim të dy VKM-ve në lidhje me subjektin.	Në proces

Nr.	Instucioni përgjegjës	Data	Tematika	Rezultati
Nr. 52	MFE dhe MBZHR	04.04.2019	Subjekti kërkon vendosjen e shafranit në listën e inputeve bujqësore të përjashtuara nga TVSH.	Trajtuar me zgjidhje
Nr. 53	Bashkia - Qarku Durrës	06.04.2019	Subjekti kërkon lehtësim për marrjen e lejes së ndërtimit për turizëm.	Në proces
Nr. 54	Bashkia - Qarku Tirane	07.04.2019	Subjekti ankohet për bllokimin e pasurisë publike.	Trajtuar me përgjigje
Nr. 55	MFE/DPT	07.04.2019	Subjekti kërkon fshirjen e gjobave nga sistemi tatimor në perfitim të ligjit të faljes.	Trajtuar me përgjigje
Nr. 56	MFE/DPT	08.04.2019	Subjekti ankohet për konkurrencë të padrejtë dhe veprimtari jashtë kontrollit ligjor dhe tatimor të konkurrencës.	Në proces
Nr. 57	MFE/DPT	09.04.2019	Subjekti ankohet në lidhje me një gjobë për mospajisjen me kase fiskale.	Trajtuar me përgjigje
Nr. 58	MFE/DPT	09.04.2019	Subjekti kërkon rishikim të gjobës së vendosur nga Administrata Tatimore, si dhe heqjen nga regjimi i TVSH-se.	Trajtuar me përgjigje
Nr. 59	Inspektoriati i Tatimeve	10.04.2019	Subjekti ankohet për detyrimet tatimore dhe ndaj Bashkise	Në proces
Nr. 60	MIE	11.04.2019	Ankesë në lidhje me Miratimin Paraprak nga MIE për ndërtimin e një impianti fotovoltaik.	Në proces
Nr. 61	Bashkia	13.04.2019	Subjekti ankohet në lidhje me penalizimin për moslëshimin e kuponit të kasës.	Në proces
Nr. 62	MBZHR	15.04.2019	Subjekti ankohet për mashtrim nëpërmjet reklamës nga konkurentet; problematika me eksportin e produkteve të kategorisë A, dhe përdorimi i ambalazhit të tyre nga subjekte rivale.	Në proces
Nr. 63	MTM	15.04.2019	Kërkesë për miratimin e procedurës dhe përditësimet përkatëse në kadastrën e pyjeve.	Në proces
Nr. 64	MFE/DPT	15.04.2019	Subjekti kërkon rimbursimin e TVSH-së.	Në proces
Nr. 65	Bashkia - Qarku Elbasan	15.04.2019	Subjekti kërkon likuidimin e një fature tenderi me Bashkinë Elbasan.	Në proces
Nr. 66	Bashkia - Qarku Vlore	15.04.2019	Subjekti kërkon mbështetje për ngritjen e qëndrës së zhytjes në Vlorë.	Në proces
Nr. 67	Bashkia - Qarku Lushnje	16.04.2019	Mosshlyerje e detyrimeve për procedurën e prokurimit.	Në proces
Nr. 68	MIE	17.04.2019	Subjekti ankohet në lidhje me ndërprerjet e energjisë që ndikojnë në funksionalitetin e fabrikës.	Në proces

Nr.	Instucioni përgjegjës	Data	Tematika	Rezultati
Nr. 69	Bashkia - Qarku Diber	18.04.2019	Subjekti ankohet në lidhje me mos likuidimin e faturave dhe dëmin ekonomik të shkaktuar nga Bashkia Klos për objekte tenderimi të përfunduara.	Në proces
Nr. 70	Bashkia - Qarku Tiranë	22.04.2019	Subjekti ankohet për mos-zbatim të vendimit gjyqësor nr. 1063 dt.13.03.2018.	Në proces
Nr. 71	MIE	22.04.2019	Subjekti kërkon zgjidhje për shtimin e fuqisë së energjisë elektrike në fabrikën e tij.	Në proces
Nr. 72	MIE	23.04.2019	Subjekti ankohet për mos-kthim përgjigje nga ana MIE	Në proces
Nr. 73	Bashkia - Qarku Tirane	23.04.2019	Subjekti ankohet për taksim në lidhje me pronësi që nuk është e subjektit.	Në proces
Nr. 74	ISHMT	24.04.2019	Subjekti kërkon ndihmë për përdorimin e një ambalazhi ku është printuar gabimisht datë skadence.	Trajtuar me përgjigje
Nr. 75	AIDA	24.04.2019	Subjekti kërkon financim për ndryshim të teknologjise së subjektit.	Në proces
Nr. 76	DPT	24.04.2019	Subjekti kërkon rimbursimin e TVSH-së kreditore.	Në proces
Nr. 77	MFE/DPD	25.04.2019	Subjekti ankohet në lidhje me mbartjen e detyrimit doganor për makineritë agrobiznes të importuara nga Gjermania, për të cilat është vendosur kod doganor pa e patur këtë të fundit.	Në proces
Nr. 78	MFE /AIDA	26.04.2019	Subjekti kërkon asistencë për përfitimin e një granti për realizimin e biznesit të tij.	Në proces
Nr. 79	MFE/DPT	26.04.2019	Subjekti ankohet në lidhje me një kontroll tatimor ndaj subjektit të cregjistruar.	Në proces
Nr. 80	MD/ALUIZNI	27.04.2019	Subjekti ankohet në lidhje me pamundesine e legalizimit të një kapanoni ne Durres.	Në proces
Nr. 81	Bashkia - Qarku Tirane	30.04.2019	Subjekti ankohet në lidhje me një gjobë vendosur kundrejt një NIPT-i pasiv, administratori i të cilit nuk jeton më.	Në proces
Nr. 82	Bashkia - Qarku Vlore	30.04.2019	Subjekti ankohet në lidhje me moslargimin e një barake të shkatërruar nga bashkia.	Në proces